



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Nr. 250/7 Prot.

Tiranë, më 19/06/2018

### V E N D I M

**Nr. 51, Datë 19.06.2018**

#### PËR

**AUDITIMI I USHTRUAR NË 7 ISH-KOMUNAT ZEJMEN, SHËNKOLL, UNGREJ,  
KALLMET, DAJÇ, KOLSH DHE BLINISHT, SOT NJËSI ADMINISTRATIVE  
BASHKIA LEZHË ME OBJEKT “AUDITIM RREGULLSHMËRI FINANCIARE”,  
PËR PERIUdhËN 01.01.2013 – 31.07.2015**

Nga auditimi i ushtruar në 7 ish- komunat Zejmen, Shënkoll, Ungrej, Kallmet, Dajç, Kolsh dhe Blinisht, sot Njësi Administrative Bashkia Lezhë, nisur nga fakti se janë konstatuar devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, në nivele materiale që justifikon dhënien e një opinioni të kualifikuar.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me qëllim përmirësimin e gjendjes.

#### VENDOSA:

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të Rregullshmërisë financiare të ushtruar në 7 ish-komunat Zejmen, Shënkoll, Ungrej, Kallmet, Dajç, Kolsh dhe Blinisht, sot Njësi Administrative Bashkia Lezhë, sipas programit nr. 250/1 prot, datë 05.03.2018 për periudhën nga data 01.01.2013 deri më datën 31.07.2015.

**II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e procedurave për vjeljen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore në ish- komunat Dajç, Zejmen, Kolsh, Blinisht Shënkoll dhe Kallmet, rezultuan debitorë të taksave e tarifave vendore me 31.07.2015, gjithsej **94** subjekte me vlerën **14,791,207 lekë**, respektivisht ish- komunat Dajç për 10 subjekte me vlerë 55,000 leke, Zejmen për 18 subjekte me vlerë 6,767,830 lekë, Kolsh për 13 subjekte me vlerë 270,368 lekë, Blinisht për 27 subjekte me vlerë 2,007,509 lekë, Shënkoll për 24 subjekte me vlerë 5,649,500 lekë dhe Kallmet për 2 subjekte me vlerë 41,000 lekë.

Nga strukturat përgjegjëse për arkëtimin e detyrimeve, nuk janë ndjekur procedurat e duhura ligjore, veprime në kundërshtim me nenin 4, 26, 32 dhe 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 40, 41 90 dhe 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenin 12, të UMF nr. 24, datë 02.09.2008, i ndryshuar, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve” (*Trajtuar hollësisht pikën III/3, faqet 91-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Lezhë në bashkëpunim me Njësitë Administrative Dajç, Shënkoll, Zejmen, Kolsh, Blinisht dhe Kallmet, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e **94 subjekteve** debitor me vlerë **14,791,207 lekë**, sipas pasqyrës aneks 2/1 bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

Për të gjitha detyrimet tatimore të pambledhura, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”, i ndryshuar, të nxirren njoftim vlerësimit tatimore duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

**a-T’u dërgohen bankave** të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit**, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**c- Për subjektet të cilët nuk** paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë“, i ndryshuar me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014, si dhe të llogariten në vazhdimësi kamata vonesa.

**d-Në se edhe pas njoftimeve** zyrtare Bizneset nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Bashkisë (Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria Juridike), të marrë masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,- *Mospagimi i taksave dhe tatimeve*.

**Brenda datës 31.10.2018**

**2. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e dokumentacionit mbi vlerësim dhe mënyrën e dorëzimit të aktivitetit të ish-komunave dhe zbatimi i procedurave të caktuara në VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë të Çështjeve Vendore dhe Ministrisë Financave nr. 3237, datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, u konstatua se nuk është bërë asnjë veprim për dorëzimin e dokumentacionit ligjorë nga ish- komunat në Bashkinë e madhe Lezhë (*Trajtuar hollësisht në pikën III/1, faqet 7-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Lezhë të evidentojë përgjegjësitë dhe të marrë masat e nevojshme për tërheqjen dhe inventarizimin e gjithë dokumentacionit ligjorë të ish komunave, në zbatim të VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

**Brenda datës 30.10.2018**

**3. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e dokumentacionit mbi administrimin e taksave e tarifave vendore të kryer në 7 ish- komunat Zejmen, Blinisht, Shënkoll, Kolsh, Kallmet, Ungrej dhe Dajç (sot NJA të Bashkisë Lezhë), u konstatua se dorëzimi i regjistrave të subjekteve private në Drejtorinë e Taksave e Tarifave Vendore Bashkia Lezhë, nuk është kryer brenda vitit 2015. Gjithashtu në kontabilitetin e Bashkisë Lezhë, nuk janë evidentuar dhe kontabilizuar detyrimet debitorë për taksa dhe tarifa vendore në fund të periudhës 31.07.2015 për shumën **14,791,207 lekë** (*Trajtuar hollësisht në pikën III/3, faqen 91-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave e Tarifave vendore Bashkia Lezhë të evidentojë përgjegjësitë dhe të marrë masa për dorëzimin e regjistrave të subjekteve fizik/ juridik dhe abonentëve familjarë, në zbatim të VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, si të bëjë kontabilizimin dhe ndjekjen e procedurave ligjore në arkëtimin e detyrimeve debitorë në vlerën **14,791,207 lekë**, sipas pasqyrës aneks 2/1 bashkëlidhur Raport Auditimit.

**Brenda datës 30.10.2018**

**4. Gjetja nga auditimi:** Në auditimin e dosjeve të procedurave të prokurimit në 7 ish- komunat Zejmen, Blinisht, Shënkoll, Kolsh, Kallmet, Ungrej dhe Dajç (sot NJA të Bashkisë Lezhë), u konstatua se dosjet nuk janë të inventarizuara dhe të numëruara, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.03 “Për Arkivat” dhe aktet ligjore në zbatim të tij dhe me përcaktimin në nenin 4/26, të ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave (UMF) nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 36. (*Trajtuar hollësisht në pikën III/2, faqen 47-88, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Lezhë nëpërmjet strukturave përkatëse të evidentojë përgjegjësitë dhe të marrë masa për inventarizimin e numërimit e plotë të tyre dhe dorëzimin e gjithë dokumentacionit të procedurave të prokurimit (*dosjet e procedurës dhe të zbatimit*), sipas kërkesave të VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, të personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe të çdo dokumenti tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

**Brenda datës 30.10.2018**

**5. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e dokumentacioni mbi menaxhimin e aseteve në ish- Komunën Dajç, u konstatua se ky proces nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e nenit 8, të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar; neni 6, të ligjit nr. 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”; VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore”, transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”; Udhëzimi nr. 3, datë 18.07.2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”; VKM nr. 1712, dt. 24.12.2008, i ndryshuar me VKM nr. 54, dt. 5.2.2014 “Për dhënien me qira ose enfitozoë të pasurive shtetërore”, i ndryshuar. Kjo situatë ka ardhur për shkak të mos funksionimit të zyrës së menaxhimit të aseteve (për prona publike, objekte, toka, troje, rrugë, pyje, kullota, etj.), strukturë e cila duhet të realizonte administrimin dhe menaxhimin e aseteve për marrjen në dorëzim dhe zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV

dhe vënien në efikasitet të ndërtesave të zëna me sipërfaqe gjithsej **5732.4 ha**, nga e cila ndërtesë me sipërfaqe 5567 m<sup>2</sup> dhe tokë e pafrytshme me sipërfaqe 165.4 ha, duke shkaktuar të ardhura të munguara nga mundësia e dhënies me qira të tyre. (Trajtuar hollësisht në pikën III/4, faqet 118-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandimi:** Bashkia Lezhë nëpërmjet strukturave përgjegjëse për administrimin e pronave, të marrë masa për evidentimin, regjistrim dhe lidhjen e kontratave të qirasë për përdorimin e sipërfaqeve të zëna prej **5732.4 ha**, për pagesën e qirasë së pronës dhe në rast mos pagese të ndiqen procedurat ligjore për lirin e pronës.

**Brenda datës 30.10.2018**

**6. Gjetje nga auditimi:** Me shkresë datë 30.03.2018 (prot subjekt nr. 1840/2, datë 30.03.2018), grupi i auditimit të KLSH ka kërkuar pranë Njësisë Administrative Zejmen dosjet e procedurave të prokurimit të zhvilluara në ish- Komunën Zejmen për periudhën 01.01.2013 – 31.07.2015.

Deri me datë 12.04.2018 (datë hartimi procesverbali), nga subjekti NJA Zejmen nuk u bë i mundur paraqitja e këtyre praktikave, duke u bërë pengesë për zbatimin e pikës 2, të programit të auditimit nr. 250/1, datë 05.03.2018, në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe konkretisht nëni 15- *Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*, VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe të çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo territorial” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2017, i ndryshuar, Kreu I, “*Organizimi i prokurimit publik*”, pika 1- “*Përgjegjësia e autoritetit kontraktor*” (Trajtuar hollësisht në pikën III/2, faqet 87-88, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1. Rekomandimi:** Bashkia Lezhë nëpërmjet Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të marrë masa për gjetjen e këtyre praktikave dhe në bazë të një programi tematik auditimi të miratuar nga Kryetari i Bashkisë, të auditoi këto praktika prokurimi të zhvilluara në periudhën 01.01.2013 – 31.07.2015, në zbatim të shkronjës (i) dhe (f) të nenit 15- *Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*, të ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 1600 dhe ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, duke njoftuar KLSH për rezultatet e këtij auditimi.

**Menjëherë**

**7. Gjetje nga auditimi:** Në ish- Komunën Kolsh dhe Zejmen, për periudhën 2013 – 2015 janë lidhur **48 kontrata** qiraje pa noter dhe pa vlerë me afat 10 vjeçar, për dhënien në përdorim të sipërfaqeve pyjore për 86.92 ha, me qëllim përmirësimin e fondit pyjorë dhe plotësimin e nevojave vetjake me material drusorë dhe prodhime të tjera.

Ndaj këtyre persona nuk është llogaritur detyrimi për qiranë për sipërfaqen e dhënë në përdorim, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullor”, ligjit nr. 10120, datë 23.04.2009 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve METN”, ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për gjuetinë” dhe VKM nr. 22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve të administrimit të pyllit komunal” detyrimet e 38 kontratave për sipërfaqen 86.92 ha të llogaritura sipas VKM nr. 391, datë 21.6.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, **për vlerën 4,172,325 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e ish- Komunës Kolsh dhe Zejmen (Trajtuar hollësisht në pikën III/4, faqet 118-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Aseteve Bashkia Lezhë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për llogaritjen e

vlerës së qirasë të **48 kontratave** të lidhura dhe arkëtimin e vlerës **4,172,325 lekë**, sipas pasqyrës 4/1 në faqen 119-127, të Raport Auditimit (aneks 4/1 dhe 4/2).

**7.1. Rekomandimi:** Në rast mos pagese të ndiqen procedurat ligjore për lirimin e pronës.

**Brenda datës 30.10.2018**

**8. Rekomandimi:** Bashkia Lezhë, në rast se zbatimi i rekomandimeve kalon në procedura gjyqësore të njoftojë KLSH-në, në cilësinë e palës së tretë që ka njohuri për çështjen që nis gjykimi.

**Vazhdimisht**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i njësisë publike*, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **24,319,418 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e dokumentacionit në ish- **Komunën Kolsh**, konstatohet se me datë 18.04.2013 është lidhur kontratë ndërmjet ish- Komunës Kolsh përfaqësuar nga F. N në cilësinë e Kryetarit të Komunës nga njëra anë dhe L. N përfaqësues i firmës “N.....I”, për dhënien me qira të objektit “*Tregu Rajonal Blegtoral Bujqësor*” me sipërfaqe ndërtese 1097 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe trualli 1950 m<sup>2</sup>, për vlerën e qirasë mujore 154,816 lekë/ muaj. Nga subjekti “N.....I”, deri në lidhjen e kontratës tjetër datë 02.07.2014, është likuiduar vlera 1,548,160 lekë, me një diferencë në vlerën **681,184 lekë**.

Me datë 02.07.2014 është lidhur kontrata e dytë e qirasë ndërmjet ish- Komunës Kolsh përfaqësuar nga F. N me detyrë Kryetar i Komunës nga njëra anë dhe shoqërisë “G.....L”, për dhënien me qira të objektit “*Tregu Rajonal Blegtoral Bujqësor*” me sipërfaqe ndërtese 1364 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe funksionale 6046 m<sup>2</sup>, për vlerën e qirasë mujore 262,578 lekë/muaj, në zbatim të VKM nr. 529, datë 08.06.2011. Nga subjekti “G.....A” deri me datë 15.06.2015 është likuiduar vlera prej 2,761,842 lekë, me një diferencë në vlerën **389,094 lekë**.

Gjithsej sipas kontratave të mësipërme për objektin “*Tregu Rajonal Blegtoral Bujqësor*” mbetet për arkëtim vlera **1,070,278 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur me dëm në buxhetin e ish- Komunës Kolsh (*Trajtuar hollësisht në pikën III/1, faqet 7-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,070,278 lekë**, *respektivisht:*

- vlera **681,184 lekë** nga subjekti “N.....I” .

-vlera **389,094 lekë** nga subjekti “G.....L” .

**Brenda datës 30.10.2018**

**2. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e veprimeve me arkën në ish- **Komunën Zejmen** për periudhën 01.01.2013 – 31.07.2015, u konstatuan parregullsi në veprimet e pagesës, konkretisht: Për vitin 2013, janë prerë 69 “*Urdhër Pagesa*”, me vlerë totale **719,700 lekë** me përshkrimin “*Blerje me lekë në dorë*”, për vitin 2014, janë prerë 82 “*Urdhër Pagesa*”, me vlerë totale **635,000 lekë** me përshkrimin “*Blerje me*

lekë në dorë” dhe për vitin 2015 janë prerë 76 “Urdhër Pagesa”, me vlerë totale **609,600 lekë** me përshkrimin “Blerje me lekë në dorë”.

Në total për të tre vitet janë prerë gjithsej 227 copë “Urdhër Pagesa” me vlerë 1,964,300 lekë, tërhequr nga ish- Kryetari i Komunës A. D, për të cilën nuk disponon asnjë dokumentacion ligjor justifikues mbi mënyrën e përdorimit të këtyre vlerave, veprime në shkelje të disiplinës financiare me **dëm ekonomik në vlerën 1,964,300 lekë**, në kundërshtim me UKM nr. 2 datë 13.05.2005, Kreu I pikën 3.1 dhe 8.3; të ligjit nr. 10296, date 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26, neni 9/4, neni 12/3; me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” pika 35,36,37,38, 42,43 dhe 44,52,54. (Trajtuar hollësisht në pikën III/1, faqet 4-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Lezhë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,964,300 lekë**, *respektivisht:*

- vlera **982,150 lekë** nga A. D me detyrë ish- Kryetar i Komunës Zejmen;
- vlera **982,150 lekë** nga V. B me detyrë ish- Përgjegjës i Zyrës së Financës.

**Brenda datës 30.10.2018**

**3. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e shpenzimeve për blerje me vlera të vogla për periudhën 01.01.2013 – 31.07.2015 të kryera në ish- **Komunën Zejmen**, konstatohet se në **8 raste me vlerë 1,452,200 lekë**, veprime janë në shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik, pasi në të gjitha rastet shpenzimet e kryera (*blerje me vlera të vogla*), nuk janë të shoqëruar me dokumentacion mbështetës dhe justifikues, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar neni 1, neni 3/9, nenin 11, neni 23/4; me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik” neni 40 dhe neni 60-61; me UKM nr. 2 datë 13.05.2005, Kreu I pikën 3.1 dhe 8.3; të ligjit nr. 10296, date 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26, neni 9/4, neni 12/3; me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” pika 35,36,37,38, 42,43 dhe 44,52,54; Urdhër MF nr. 57, datë 12.06.2014 “Për Gjurmët standarde të Auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”; me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me UMF nr. 2 datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 98, *respektivisht:*

*Për vitin 2013 janë 5 raste me vlerë 978,500 lekë, për vitin 2014 janë 2 raste me vlerë 233,700 lekë dhe për vitin 2015 (periudha e gjashtë mujorit të parë), është një rast me vlerë 60,000 lekë (Trajtuar hollësisht në pikën III/1, faqet 7-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Lezhë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,452,200 lekë**, *respektivisht:*

- vlera **363,050 lekë** nga A. D me detyrë ish- Kryetar i Komunës Zejmen, në cilësinë e Titullarit të AK;
- vlera **363,050 lekë** nga V. B me detyrë ish- Përgjegjëse e Zyrës së Financës, në cilësinë e Kryetarit të KBVV.
- vlera **363,050 lekë** nga E. M me detyrë ish- Sekretar i Këshillit të Komunës Zejmen, në cilësinë e Kryetarit të KBVV
- vlera **363,050 lekë** nga P. L me detyrë ish- Inspektor i Taksave e Tarifave Vendore, në cilësinë e Kryetarit të KBVV.

**Brenda datës 30.10.2018**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt: “Asfaltim i rrotonte ishull Shëngjin – Stom” ish- Komuna Shëngjin, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Komuna Shëngjin dhe shoqërisë “K.....S”, rezultojnë diferenca në volume për punime inxhinierie të pakryera, duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë në vlerën **560,448 lekë** (Trajtuar hollësisht në pikën III/2.1, faqet 88-91, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **560,448 lekë** nga shoqëria “**K.....S**”, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “*Asfaltim i rrugës rrotonte ishull Shëngjin – Stom*”.

**Brenda datës 30.10.2018**

**5. Gjetje nga auditimi:** Në ish- **Komunën Ungrej**, me datë 17.11.2013 është lidhur kontratë qiraje midis ish- Kryetarit të Komunës GJ. GJ nga njëra anë dhe V. N (kontratë Tip) “*Për dhënien e tokës bujqësore të pandarë, pasuri e Komunës Ungrej*” me sipërfaqe **12.8 ha**, në ZK 2109, e ndodhur në pasurinë nr. 169,166, 162/2-B, 159/1-B,158/2-B,165,167/1-B,162/1-B, Indeksi i hartës K-34-76-(75-A), Fshati Kashnjet, sipas vendimit të KK nr. 01, datë 15.11.2013 “Për dhënien me qira të tokave Bujqësore të pandara”. Kohëzgjatja e kësaj kontrata është për 99 vjet me vlerë 79,460 lekë/viti.

Pasuria është objekt i ligjit nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, VKM nr. 531, datë 21.08.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, i ndryshuar, UKM nr 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, UMB nr. 10, datë 13.09.2012 “Për mënyrën e përlllogaritjes së kriterëve të vlerësimit të ofertave për marrjen me qira të tokës bujqësore, të pandarë”.

Nga ana e qiramarrësi V. N, nga vlera e detyrimit për pagesë prej 317,840 lekë është likuiduar vlera 39,866 lekë (bankën Credins, sipas mandat pagesës datë 31.03.2015), dhe mbetet për pagesë vlera **277,974 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e ish- Komunës Ungrej (*Trajtuar hollësisht në pikën III/4, faqet 118-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Aseteve Bashkia Lezhë dhe Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **277,974 lekë nga V. N**.

**Brenda datës 30.10.2018**

**6. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e dokumentacionit të tenderi me objekt: “*Ndërtim ujësjellësi në fshatin Troshan*” të zhvilluar në ish- **Komunën Blinisht**, konstatohet se fondit limit prej 83,146,690 lekë nuk është preventivuar sipas çmimeve të manualit teknik të miratuara në VKM nr. 568, datë 27.06.2013 “Për miratimin e manualeve teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike”, me ndryshime, pasi disa zëra çmimet e preventivuar nuk janë sipas manualit, duke rënduar padrejtësisht fondin limit për vlerën **3,615,615 lekë, dëm ekonomik** në ish- buxhetin e Komunës Blinisht (*Trajtuar hollësisht në pikën III/2, faqet 47-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Lezhë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **3,615,615 lekë**, nga personi përgjegjës për hartimin e preventivit **ing. M. P.**

**Brenda datës 30.10.2018**

**7. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e procedurës së prokurimit me objekt: “*Ndërtim ujësjellësi në fshatin Troshan*” të zhvilluar në ish- **Komunën Blinisht**, me fond limit 83,146,690 lekë, konstatohet se operatori i shpallur fitues “**A.....U**” me ofertë 82,946,690 lekë, nuk plotëson kriteret e DST, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, si: -*Xhiros e deklaruar sipas vërtetimit të lëshuar nga Administrata Tatimore nuk përputhet me xhiron e deklaruar në pasqyrat financiare të viteve respektive; - Nuk paraqet punime të ngjashme; -Nuk ka deklaruar me deklaratë se kush është drejtuesi teknik.*

Gjithashtu nga verifikimi, konstatohet se KVO ka skualifikuar padrejtësisht shoqërinë “**GJ.....N**” me ofertë 69,920,900 lekë ose më e ulët se operatori fitues për vlerën 13,025,790 lekë, veprime me efekt negativ në përdorimin e fondit të prokuruar dëm ekonomi për vlerën **13,025,790 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1-

“Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2- “Parimet e përzgjedhjes” germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55 (Trajtuar hollësisht në pikën III/2, faqet 47-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1. Rekomandimi:** Bashkia Lezhë të marrë masat të analizoj me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet dhe arsyet për dëmin ekonomik të shkaktuar deri në arkëtimin e vlerës **13,025,790 lekë**, për kualifikimin e padrejtë të OE “A.....U”, i cili nuk përmbush kriteret për kualifikim.

**Brenda datës 30.10.2018**

**8. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Ndërtim ure auto 2HD, 10 m mbi përroin e Kalivaçit”, në ish- **Komunën Ungrej**, konstatohet se shoqëria “A.....I” është tërhequr nga konkurrimi me pretendimin se nuk plotësonte nenin 9 të kontratës, ku thuhet se “Pagesa sipas grafikut është 20% e pagesës në momentin e marrjes në dorëzim të objektit dhe pjesa tjetër pas çeljes së fondeve”.

Argumenti i përdorur nga shoqëria ‘A.....N’, nuk është bindës dhe argumentues, pasi operatorët pjesëmarrës janë njohur me kushtet e kontratës, përpara se të zhvillohej procedura sipas kontratës së paraqitur në DST. Kështu ndaj subjektit “A.....I” duhej bërë sekuestrimi i sigurimit të ofertës në vlerën **201,705 lekë** bërë në shoqërinë “S.....A” me ref 56220-03-23-2012, datë 18.4.2012, vlerë e cila konsiderohet dëm ekonomik (Trajtuar hollësisht në pikën III/2, faqet 84-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Lezhë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **201,705 lekë**, nga shoqëria “A.....I”.

**Brenda datës 30.10.2018**

**9. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Ndërtim ure auto 2HD, 10 m mbi përroin e Kalivaçit”, në ish- **Komunën Ungrej**, konstatohet se shoqëria “G....I” me ofertë 7,630,500 lekë është skualifikuar padrejtësisht nga KVO, me pretendimin se është ofertë anomalisht e ulët. Nga verifikimi i ofertave të paraqitur nga operatorët pjesëmarrës, konstatohet se oferta e shoqërisë “G....I” nuk është anomalisht e ulët, veprime me efekt negativ në përdorimin e fondit të prokuruar me dëm ekonomik në vlerën **1,959,960 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1-“Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2- “Parimet e përzgjedhjes” germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55 (Trajtuar hollësisht në pikën III/2, faqet 84-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1. Rekomandimi:** Bashkia Lezhë të marrë masat të analizoj me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet dhe arsyet për dëmin ekonomik të shkaktuar deri në arkëtimin e vlerës **1,959,960 lekë**, për skualifikimin e padrejtë të OE “G....I”.

**Brenda datës 30.10.2018**

**10. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës së shkollës Kallmet i madh (faza I)” të zhvilluar në ish- **Komunën Kallmet**, me fond limit 2,266,224 lekë dhe fitues shoqërinë “O.....D” me ofertë 2,191,150 lekë, konstatohet se operatori i shpallur fitues (O.....D), nuk plotëson kriteret e DST të vendosura nga AK, pasi ka mangësi, si: -Licenca e shoqërisë me nr. NZ 1367/4, datë 5.5.2008 dhe afat vlefshmërie 05.05.2019 ( 5 vjet), nuk ka kategorinë e punimeve NP-9A, pika 4.7/c e DST; -Nuk disponon mjet “FADROM” dhe “Makineri për prerje asfalti”, veprime me efekt negativ në përdorimin e fondit të prokuruar me **dëm ekonomi 191,148 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1-“Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2- “Parimet e përzgjedhjes” germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55 (Trajtuar hollësisht në pikën III/2, faqet 64-70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



**10.1. Rekomandimi:** Bashkia Lezhë të marrë masat të analizoj me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet dhe arsyet për dëmin ekonomik të shkaktuar deri në arkëtimin e vlerës **191,148 lekë**, për kualifikimin e padrejtë të OE “O.....D”, pasi nuk plotëson kriteret e DST.

**Brenda datës 30.10.2018**

## **B/2. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e procedurës së prokurimit të zhvilluar në ish- **Komunën Dajç**, u konstatua se tenderi me objekt: “*Udhëtim tematik i Këshilltarëve të Këshillit të Komunës Dajç, Dajç-Stamboll-Dajç*”, me fond limit 1,666,667 lekë, ku fitues është shpallur operatori “L.....0” me ofertë 1,666,500 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka vlerësuar drejt OE “L.....0”, pasi nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, si: -Nga subjekti nuk paraqitet vërtetimi për pagesën e energjisë elektrike të muajt koherent; -Sipas DST është kërkuar vërtetim për taksat vendore për tre vitet e fundit (2011-2012-2013), në të gjitha njësitë ku kryhen aktivitetet. Kështu sipas dokumenteve, shoqëria ka paraqitur vërtetim vetëm për vitin 2014 dhe jo për tre vitet që kërkohet, veprime të cilat kanë çuar në vlerësimin padrejtësisht si fitues të OE “L.....0”, të cilat kanë çuar në përdorimin me efekt negative për eficientësin e fondeve të prokuruar në vlerën **1,666,667 lekë** (*Trajtuar hollësisht në pikën III/2, faqet 60-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1 Rekomandimi:** Bashkia Lezhë nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/e shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **1,666,667 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

**Në vijimësi**

## **B/3. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA E TOKËS.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, u konstatua se nga ish komunat Zejmen, Shënkoll, Ungrej, Kallmet, Dajç, Kolsh dhe Blinisht, nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme shtrënguese në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, nenet 70, 90, 91, 114, ligjit nr. 9482, datë 03.04.20106, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar”, për vlerën e detyrimit të paarkëtuara në shumën **14,791,207 lekë** (*Trajtuar hollësisht në pikën III/3, faqet 91-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1.Rekomandimi:** Bashkia Lezhë nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa e nevojshme shtrënguese për vjeljen e detyrimeve të paarkëtuara në shumën 14,791,207 lekë.

Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë, nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH, i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative, të bëhet kallëzim penal.

**Brenda datën 30.09.2018**

**2. Gjetje nga auditimi:** Në ish- Komunën Kolsh dhe Zejmen janë lidhur **48 kontrata** qiraje pa noter dhe pa vlerë me afat 10 vjeçar, për dhënie në përdorim të sipërfaqeve pyjore për 86.92 ha, me qëllim përmirësimin e fondit pyjorë dhe plotësimin e nevojave vetjake me material drusorë dhe prodhime të tjera.

Ndaj këtyre persona nuk është llogaritur detyrimi për qiranë për sipërfaqen e dhënë në përdorim, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullor”, ligjit nr. 10120, datë 23.04.2009 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve METN”, ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për gjuetinë” dhe VKM nr. 22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve të administrimit të pyllit komunal” detyrimet e 38 kontratave për sipërfaqen 86.92 ha të llogaritura sipas VKM nr. 391, datë 21.6.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, **për vlerën 4,172,325 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e ish- Komunës Kolsh dhe Zejmen (*Trajtuar hollësisht në pikën III/4, faqet 118-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Lezhë nëpërmjet strukturave përkatëse të marrë masat e nevojshme aplikimin e vlerës së qirasë së kontratave të lidhura dhe arkëtimin e detyrimit të pallogaritur dhe arkëtuar të qirasë në vlerën 4,172,325 lekë, sipas pasqyrës 4/1 në faqen 119-127, të Raport Auditimit (aneks 4/1 dhe 4/2). Ne rast mos pagese të ndiqen procedurat ligjore për lirimin e pronës. Ne rast mos pranimit të vlerës së kontratës, të kërkohet prishja e tyre.

**Brenda datës 30.10.2018**

## **D. MASA ADMINISTRATIVE:**

### **D/1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në akt-konstatimet nr. 22, datë 19.04.2018 (ish- Komuna Dajç), nr. 23, datë 19.04.2018 (ish- Komuna Ungrej), nr. 25, datë 19.04.2018 (ish- Komuna Kallmet) dhe nr. 27, datë 29.04.2018 (ish- Komuna Blinisht), vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit. Mbështetur në nenet 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për 17 (nëntëmbëdhjetë) punonjësve dhe ish-punonjësve, si më poshtë:**

### **I- Për ish- Komunën Blinisht.**

- 1. N. K** me detyrë Sekretar, në cilësinë e Kryetarit të KVO
- 2. S. L** me funksion Administrator NJA Blinisht;
- 3. F. M** me funksion specialiste në zyrën e tatime NJA Blinisht;
- 4. E. O** me funksion ish- arkivist, dhe
- 5. N. LL** me funksion Specialist Pyjesh në NJA Blinisht.

Në cilësinë e anëtarëve të KVO, në 1 (një) procedurë prokurimi:

### **Për shkeljet e mëposhtme:**

**1- Tenderi me objekt:** “Ndërtim ujësjellësi në fshatin Trojan”, me fond limit 83,146,690 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “A.....U” me vlerë 82,946,690 lekë.

OE “A.....U” i shpallur fitues nuk plotëson kërkesat e DST, pasi ka këto mangësi: - *Nuk përputhet xhiros e deklaruar sipas vërtetimit të lëshuar nga Administrata Tatimore me shkresën nr. 6378, datë 15.4.2015 me xhiron e deklaruar në pasqyrat financiare të viteve respektive;* - *Nuk plotëson piken 2.3/a ose b të DST, pasi nuk paraqet punime të ngjashme;* - *Nuk ka deklaruar me deklaratë se kush është drejtuesi teknik;*

Gjykojmë se vendimi i marrë nga KVO për kualifikimin e OE “A.....U” me ofertë 82,946,690 lekë pa TVSH është me dy standarde, pasi për të njëjtat mangësi që grupi i auditimit të KLSH ka konstatuar ndajë operatorit fitues, nga KVO janë skualifikuar operatorë të tjerë të cilat në disa raste nuk qëndrojnë (trajtuar më sipër), dhe me ofertë më të leverdishme se operatori fitues, duke mos vlerësuar kriterin kryesorë “*çmimi i leverdishëm*“, veprime të cilat kanë çuar në përdorim me efekt negativ me dëm të fondeve publike në vlerën **13,025,790 lekë** (Trajtuar në faqen 47-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe akt-konstatimin nr. 27, datë 19.04.2018).

## **II- Në ish- Komunën Dajç.**

**1. F. F** me detyrë ish- Zv/Kryetar Komune, në cilësinë e Kryetarit të KVO;

**2. V. Z** me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Kadastrës NJA Dajç, dhe

**3. F. Z** me detyrë ish- arshivist.

Në cilësinë e anëtarëve të KVO, në 1 (një) procedurë prokurimi:

### **Për shkeljet e mëposhtme:**

**1- Tenderi me objekt:** “Udhëtim tematik i Këshilltarëve të Këshillit të Komunës Dajç, Dajç-Stamboll-Dajç”, me fond limit 1,666,667 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “L.....0” me vlerë 1,666,500 lekë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të OE të shpallur fitues “L.....0” me ofertë 1,666,500 lekë pa TVSH, konstatohet se nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, konkretisht: -*Nga subjekti nuk paraqitet vërtetimi për pagesën e energjisë elektrike të muajt koherent;* -*Sipas DST është kërkuar vërtetim për taksat vendore për tre vitet e fundit (2011-2012-2013), në të gjitha njësitë ku kryhen aktivitet;*

Gjykojmë se vendimi i marrë nga KVO për s’kualifikimin e OE “L.....0” me ofertë 1,666,500 lekë pa TVSH, nuk është i drejtë dhe duhet të ish s’kualifikuar, duke anuluar procedurën dhe zhvilluar procedurë të re me kriteret të tjera më të favorshme, në mënyrë që të rritet dhe numër i pjesëmarrës dhe të shmangej përdorimi i fondeve publike pa efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet në vlerën **1,666,667 lekë** (Trajtuar në faqen 60-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe akt-konstatimin nr. 22, datë 19.04.2018).

## **III- Në ish- Komunën Kallmet.**

**1. N. Z** me funksion Administrator i NJA Kallmet, në cilësinë e Kryetarit të KVO;

**2. D. M** me funksion ish- Punonjës Shërbimesh Komuna Kallmet, dhe

**3. M. P** me funksion inxhinier në Drejtorinë ALUZNI Lezhë.

Në cilësinë e anëtarëve të KVO, në 1 (një) procedurë prokurimi:

### **Për shkeljet e mëposhtme:**

**1- Tenderi me objekt:** “Rikonstruktion i rrugës së shkollës Kallmet i madh (faza I)”, me fond limit 2,266,224 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “O.....D” me vlerë 2,191,150 lekë. Konstatohet se operatori “O.....D” nuk plotëson kriteret e DST, konkretisht: -*Nuk paraqet certifikatë të gjendjes financiare në masën 10% e fondit limit me nja nga bankat;* -*Licenca e shoqërisë me nr. NZ 1367/4, datë 5.5.2008 dhe afat vlefshmërie 05.05.2019 ( 5 vjet), nuk ka kategorinë e punimeve NP-9A, pika 4.7/c e DST;* -*Drejtuesja teknike E. L me kontratë pune datë 7.04.2008 dhe me afat 5 vjet (nga data 07.04.2018 – 07.04.2013), nuk është vlefshme;* -*Nuk paraqet vërtetim për pagesën e taksave vendore, spia pikës 2 të DST;* -*Nuk disponon mjet “FADROM” dhe “Makineri për prerje asfalti”.*

Vendimi i marrë nga KVO për kualifikimin e “O.....D” me ofertë 2,191,150 lekë pa TVSH, nuk është i drejtë dhe duhet të ishte skualifikuar, siç është vepruar dhe me OE të tjerë. Në kushtet kur asnjë nga OE pjesëmarrës nuk plotësojnë kërkesat e DST, procedura duhej anuluar ose midis operatorëve me mangësi, të cilat mund të klasifikohen dhe si devijime të vogla (subjekti “D.....X” me ofertë 2,000,002 lekë pa TVSH), të vlerësohej kriteri kryesor “çmimi i leverdishëm“, veprime të cilat kanë çuar në përdorim me efekt negativ të fondeve publike **me dëm në vlerën 191,148 lekë** (Trajtuar në faqen 70-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe akt-konstatimin nr. 25, datë 19.04.2018).

#### **IV- Në ish- Komunën Ungrej.**

- 1. A. B**, me funksion ish- Juriste e Komunës Ungrej, në cilësinë e Kryetarit të NJP;
  - 2. Arben Nikolli** me funksion ish-Specialist në Zyrën e Shërbimit Pyjor, dhe
  - 3. Liza Kola** me funksion Administratore e Ndhmës Ekonomike NJA Ungrej, në cilësinë e anëtarëve të NJP;
  - 4. D. D** me funksion ish- Përgjegjëse e Zyrës së Financës, në cilësinë e Kryetarit të KVO;
  - 5. G.J. N** me funksion Nënpunës i Gjendjes Civile NJA Ungrej, dhe
  - 6. Z. P. P** me funksion ish- Sekretar i Këshillit të Komunës.
- Në cilësinë e anëtarëve të KVO, në 1 (një) procedurë prokurimi:

#### **Për shkeljet e mëposhtme:**

**1- Tenderi me objekt:** “Ndërtim ure auto 2HD, 10m mbi përroin e Kalivaçit” me fond limit 10,085,039 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “GJ.....I” me vlerë kontrate 9,590,460 lekë.

Në auditimin e kësaj praktike, konstatohen këto mangësi:

**a-**Kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me dispozitat e ligjit dhe VKM nr. 42, pasi janë vendosur kategori licence “C:”, kur vlera e investimit është 10 milion lekë.

**b-**Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), ka s’kualifikuar nga gara shoqërinë “G....I me ofertë 7,630,500 lekë, duke e klasifikuar si ofertë anomalisht të ulët, gjë e cila nuk është e vërtete, pasi oferta nuk është anomalisht, duke kualifikuar shoqërinë “GJ.....I” me ofertë 9,590,460 lekë pa TVSH, veprime me dëm ekonomik në **vlerën 1,959,960 lekë**, si diferencë ndërmjet shoqërisë “G.....I” dhe “GJ.....I” (Trajtuar në faqen 84-88, të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe akt-konstatimin nr. 23, datë 19.04.2018).

#### **E. MASA DISIPLINORE**

##### **E/1. Për punonjësit që nuk janë në marrëdhëniet e punës me Bashkinë Lezhë.**

Për **6 ish- punonjësit** e larguar nga detyra dhe që nuk kanë adresim institucional, të cilët kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Bashkinë Lezhë, por që atakohen me Raportin Përfundimtar të Auditimit, propozimi i masave disiplinore quhet i ezauruar, *respektivisht*:

- 1. A. D** me funksion ish- Kryetar i Komunës Zejmen.
- 2. F. N** me funksion ish- Kryetar i Komunës Kolsh.
- 3. V. B** me funksion ish- Përgjegjëse e Zyrës së Financës.
- 4. E. M** me funksion ish- Sekretar i Këshillit të Komunës.
- 5. P. L** me funksion ish- Inspektor i Zyrës së Taksave Vendore.
- 6. A. M** me funksion ish-Zv/Kryetar i Komunës Kolsh.

#### **F. KALLËZIM PENAL:**

Bazuar në nenin 281 të ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa (a), (b)

dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, si dhe germa (gj) e nenit 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, *sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik* nga ana e Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit në kuptim të referencave të Kodit Penal, për **11 punonjës dhe ish- punonjës**, si më poshtë:

### **I- Për ish- Komunën Blinisht.**

1. **N. K** me detyrë Sekretar, në cilësinë e Kryetarit të KVO
  2. **S. L** me funksion Administrator NJA Blinisht;
  3. **F. M** me funksion specialiste në zyrën e tatime NJA Blinisht;
  4. **E. O** me funksion ish- arkivist, dhe
  5. **N. LL** me funksion Specialist Pyjesh në NJA Blinisht.
- Në cilësinë e anëtarëve të KVO, në 1 (një) procedurë prokurimi:

#### **Për shkeljet e mëposhtme:**

**1- Tenderi me objekt:** “*Ndërtim ujësjellësi në fshatin Trojan*”, me fond limit 83,146,690 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “A.....U” me vlerë 82,946,690 lekë.

Operatori ekonomik “A.....U” i shpallur fitues nuk plotëson kërkesat e DST, pasi ka këto mangësi: - Nuk përputhet xhiros e deklaruar sipas vërtetimit të lëshuar nga Administrata Tatimore me shkresën nr. 6378, datë 15.4.2015 me xhiron e deklaruar në pasqyrat financiare të viteve respektive; - Nuk plotëson piken 2.3/a ose b të DST, pasi nuk paraqet punime të ngjashme; - Nuk ka deklaruar me deklaratë se kush është drejtuesi teknik;

Gjykojmë se vendimi i marrë nga KVO për kualifikimin e OE “A.....U” me ofertë 82,946,690 lekë pa TVSH është me dy standarde, pasi për të njëjtat mangësi që grupi i auditimit të KLSH ka konstatuar ndajë operatorit fitues, nga KVO janë skualifikuar operatorë të tjerë të cilat në disa raste nuk qëndrojnë (trajtuar më sipër), dhe me ofertë më të leverdishme se operatori fitues, duke mos vlerësuar kriterin kryesorë “*çmimi i leverdishëm*“, veprime të cilat kanë çuar në përdorim me efekt negativ me dëm të fondeve publike në vlerën **13,025,790 lekë** (Trajtuar në faqen 47-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe akt-konstatimin nr. 27, datë 19.04.2018)..

### **II- Në ish- Komunën Ungrej.**

1. **GJ. GJ**, me funksion Administrator i NJA Ungrej, në cilësinë e Titullarit të AK ish- Komuna Ungrej për miratimin e procedurës me shkelje.
2. **D. D** me funksion ish- Përgjegjëse e Zyrës së Financës, në cilësinë e Kryetarit të KVO;
3. **GJ. N** me funksion Nënpunës i Gjendjes Civile NJA Ungrej, dhe
4. **Z. P. P** me funksion ish- Sekretar i Këshillit të Komunës.

Në cilësinë e anëtarëve të KVO, në 1 (një) procedurë:

#### **Për shkeljet e mëposhtme:**

1- Tenderi me objekt: “*Ndërtim ure auto 2HD, 10m mbi përroin e Kalivaçit*” me fond limit 10,085,039 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “GJ.....I” me vlerë kontrate 9,590,460 lekë.

Në auditimin e kësaj praktike, konstatohen këto mangësi:

a-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), ka skualifikuar, por nuk ka shpallur fitues shoqërinë “G.....I me ofertën më të ulët 7,630,500 lekë, pasi e ka përcaktuar si ofertë anomalisht të ulët, në kundërshtim me metodën e llogaritjes në DST dhe ka vendosur fitues shoqërinë “GJ.....I” me ofertë 9,590,460 lekë pa TVSH, duke shkaktuar dëm ekonomik në **vlerën 1,959,960 lekë**, si diferencë ndërmjet ofertës së shoqërisë “G.....I” dhe “GJ.....I” (Trajtuar në faqen 47-89, të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe akt-konstatimin nr. 23, datë 29.04.2018).

### **III- Në ish- Komunën Zejmen:**

**1. A. D** me funksion ish- Kryetar i Komunës Zejmen.

**2. z. V. B** me funksion ish- Përgjegjës e Zyrës së Financës.

#### **Për shkeljet e mëposhtme:**

-Në auditimin e veprimeve me arkën në **ish- Komunën Zejmen** për periudhën 01.01.2013 – 31.07.2015, u konstatuan parregullsi në veprimet e pagesës, konkretisht: Për vitin 2013, janë prerë 69 “Urdhër Pagesa”, me vlerë totale **719,700 lekë** me përshkrimin “Blerje me lekë në dorë”, për vitin 2014, janë prerë 82 “Urdhër Pagesa”, me vlerë totale **635,000 lekë** me përshkrimin “Blerje me lekë në dorë” dhe për vitin 2015 janë prerë 76 “Urdhër Pagesa”, me vlerë totale **609,600 lekë** me përshkrimin “Blerje me lekë në dorë”.

Në total për të tre vitet janë prerë gjithsej 227 copë “Urdhër Pagesa” me vlerë 1,964,300 lekë, tërhequr nga ish- Kryetari i Komunës A. D, për të cilën nuk disponon asnjë dokumentacion ligjor justifikues mbi mënyrën e përdorimit të këtyre vlerave, veprime në shkelje të disiplinës financiare me **dëm ekonomik në vlerën 1,964,300 lekë**, në kundërshtim me UKM nr. 2 datë 13.05.2005, Kreu I pikën 3.1 dhe 8.3; të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26, neni 9/4, neni 12/3; me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” pika 35,36,37,38, 42,43 dhe 44,52,54. (*Trajtuar gjerësisht në faqen 40-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe akt-konstatimin nr. 14, datë 19.04.2018*).

-Për pengesën e krijuar ndaj grupit të auditimit, në mos zbatimin e pikës II- “*Auditimi i prokurimit të fondeve publike për mallra, punime civile, shërbime dhe ankande*”, të programit të auditimit nr. 250/1, atë 05.03.2018, pasi:

Me shkresën datë 30.03.2018 (*prot subjekt nr. 1840/2, datë 30.03.2018*), grupi i auditimit të KLSH ka kërkuar pranë Njësisë Administrative Zejmen, Bashkia Lezhë, dosjet e procedurave të prokurimit të zhvilluara në ish- Komunën Zejmen për periudhën 01.01.2013 – 31.07.2015.

Nga ana e subjekti nuk u bë i mundur paraqitja e dokumentacionit ligjorë (dosjeve) të procedurave të prokurimit të zhvilluar në ish- Komunën Zejmen, duke u bërë pengesë për zbatimin e pikës II, të programit të auditimit nr. 250/1, datë 05.03.2018, veprime në kundërshtim me shkronjat (dh, e) të nenit 15- Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2017, i ndryshuar, Kreu I, “Organizimi i prokurimit publik”, pika 1- “Përgjegjësia e autoritetit kontraktor” (*Trajtuar hollësisht në pikën III/2, faqet 87-88, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**G.** Për shkak se përgjegjësi i grupit të auditimit ka qenë i angazhuar në dy programe auditimi (7 ish-komunat Zejmen, Shënkoll, Ungrej, Kallmet, Dajç, Kolsh dhe Blinisht dhe në Bashkinë Lezhë), dhe fakti që problemet e administrimit të pronave dhe kontratat e qirasë së objekteve, tokat bujqësore, pyjet/kullotat nuk janë verifikuar nga përgjegjësi i grupit, ky auditim për këtë pjesë do të vijojë të verifikohet në auditimin në proces dhe përsëri në auditimin e radhës në Bashkinë Lezhë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**